

**PLANI STRATEGJIK DHE PLANI I
VEPRIMIT PËR ZYRËN E INSPEKTORIT
TË LARTË TË DREJTËSISË
2020-2022**

PËRMBAJTJA E LËNDËS

LISTA E SHKURTIMEVE

FJALA PËRSHËNDETËSE E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

KREU I –HYRJE DHE METODOLOGJIA E PËRDORUR

KREU II - ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

1. Situata aktuale
2. Vlerësimi i riskut
3. Lidhja me dokumente të tjerë strategjikë

KREU III- VIZIONI, MISIONI, VLERAT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIK

Qasja e përgjithshme për objektivat strategjik

1. Fuqizimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale
2. Zhvillimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare
3. Pjesëmarrje aktive në proceset e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional
4. Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

KREU IV - BURIMET FINANCIARE

1. Buxheti i shtetit

KREU V - MONITORIMI DHE RAPORTIMI

1. Monitorimi
2. Raportimi

PLANI I VEPRIMIT 2020-2022

LISTA E SHKURTIMEVE

ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
KLQJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
MD	Ministria e Drejtësisë
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SND	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit
SNRAP	Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
SPI	Sistemi Planifikimi të Integruar
BE	Bashkimi European
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin European
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
TI	Teknologji e Informacionit
TIK	Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit
DPÇSHJ	Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve dhe Shërbimeve Juridike
DESHM	Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse



FJALA PËRSHËNDETËSE E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri i është nënshtruar së fundmi një sërë reformash të thella, në funksion të përmbushjes së standardeve evropiane në këtë sistem. Një nga organet e reja, i cili është krijuar në kuadër të reformës në drejtësi është edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Ngritja dhe funksionimi i këtij institucioni të ri kushtetues duhet të realizohet nëpërmjet një Sistemi Planifikimi të Integruar (SPI), si dhe sigurimit të një sërë mekanizmave të përshtatshëm të qeverisjes, monitorimit, raportimit, metodave dhe treguesve (indikatoreve) të mirëpërcaktuar, së bashku me mbështetjen e duhur financiare për zbatimin e tyre. Ky proces, kërkon një qasje ndërsektoriale, në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar.

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është hartimi i një Plani Strategjik dhe Plani Veprimi për periudhën 2020-2022 për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në harmoni me të gjithë procesin e planifikimit strategjik, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim, Agjenda e Integritimit Evropian, metodat e planifikimit të programit buxhetor afatmesëm, ndihmën e huaj, si dhe harmonizimin dhe koordinimin e veprimtarisë së punës së institucionit me organet e tjera të sistemit të drejtësisë.

Ngritja dhe funksionimi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas një sistemi planifikimi të integruar siguron planifikimin, vlerësimin e zbatimit, si dhe ndryshimin apo përmirësimin e përmbajtjes së aktiviteteve konkrete, të cilat do të ndiqen nga ana e institucionit në kuadër të organizimit dhe funksionimit të tij. Në të njëjtën kohë, hartimi dhe planifikimi i objektivave apo masave të parashikuara, janë kryer duke u nisur nga nevojat e identifikuara nga ekspertët e angazhuar në procesin e hartimit të këtij plani strategjik, nevojat që pasqyrohen nga kuadri i përgjithshëm institucional dhe ligjor që rregullon organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe nevojat e pasqyruara nga faktorët e rrezikut të jashtëm apo të brendshëm që potencialisht ndikojnë në veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Në këtë dokument janë përcaktuar objektivat strategjik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në disa drejtime kryesore, për periudhën 2020 - 2022. Çdo objektiv strategjik i synuar është ndërlidhur me masa/aktivitete për zbatimin e tyre dhe afatin e realizimit të tyre, të cilat do të monitorohen sipas raportimeve periodike, lidhur mbi nivelin e zbatimit të aktiviteteve të parashikuara.

Realizmi i këtij dokumenti ka kaluar nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës konsultimi ndërinstitucional dhe publik dhe në emër të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shfrytëzoj rastin që të shpreh falenderimin e sinqertë edhe për të gjithë ata që na ndihmuan në hartimin e këtij dokumenti dhe besuan në punën e stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Artur Metani
Inspektor i Lartë i Drejtësisë

KREU I - HYRJE DHE METODOLOGJIA E PËRDORUR

Me konstituimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, lindi si domosdoshmëri përcaktimi i objektivave të punës për dy vitet në vijim dhe arritjen e rezultateve në bazë të objektivave. Në vlerësim të kompetencave dhe mundësive objektive, plani strategjik për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka për qëllim:

a) Të sigurojë kontribute për planet e veprimit për fazën tjetër të zhvillimit të reformës në drejtësi për 2021-2025 (SND II);

b) Të shërbejë si një bazë për një planifikim të përgjithshëm për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe për menaxhimin e performancës, gjë e cila kërkon të plotësohet me plane të detajuara vjetore të punës dhe me të dhëna periodike të marra nga strukturat përbërëse të institucionit.

Puna për planin strategjik dhe planin e veprimit filloi në maj të vitit 2020 dhe vazhdoi deri në fund të qershorit me një projekt fillestar. Gjatë muajit shtator-nëntor u ripunua projekti i strategjisë duke rishikuar dhe verifikuar treguesit. Në tetor 2020, në sajë të angazhimit të përbashkët institucional u dakordësua dhe u finalizua projektstrategjia dhe plani i veprimit, të cilët në fund të muajit tetor u konsultua sërish me të gjithë strukturat e brendshme të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe institucionet qendrore.

Buxheti është dakordësuar me ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë në tetor 2020 nga ku rezultoi dokumenti final prej muajit nëntor.

Puna ka përfshirë fillimisht një grup prej 2 personash, kjo pasi në muajin maj 2020 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka pasur mungesë në burime njerëzore dhe mandej në muajtë shtator-nëntor, pjesë e grupit ka qënë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve dhe Shërbime Juridike e cila bëri finalizimin e planit strategjik dhe planit të veprimit duke u ndihmuar edhe nga njësia e ndihmës inspektorëve.

Plani strategjik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është hartuar në përputhje me kornizën e Sistemit të Planifikimit të Integruar, duke u bazuar në koordinimin midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave që përfshihen në SKZHI, si dhe duke zbatuar një qasje sistematike dhe të integruar në zhvillimet e procesit të Integritimit Evropian, në kërkesat e Programit Buxhetor Afatmesëm, në programin e investimeve publike dhe atë të ndihmës së huaj.

Plani përputhet me objektivat afatmesme dhe afatgjata të qeverisjes, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, si dhe Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Në të njëjtën kohë, përmbajtja e këtij plani strategjik është konceptuar edhe në përputhje me objektivat dhe një sërë masash të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit

për periudhën 2015-2023, si dhe në Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP) 2015-2020.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar sfidave me të cilat është hasur Zyra e Inspektorit të Lartë që në momentin e krijimit, duke nisur më mungesën në burime njerëzore dhe në infrastrukturë si dhe gjendjen e shkaktuar nga pandemia globale. Gjithashtu është bërë edhe një analizë rreth situatës aktuale në të cilën ndodhet institucioni dhe dhënë një info e përmbledhur në lidhje me numrin e ankesave dhe trajtimin e tyre dhe gjendjen aktuale të stafit.

Procesi i hartimit të strategjisë dhe planit të veprimit është realizuar duke mbajtur në konsideratë kombinimin e përparësive me mundësitë që institucioni ka në dispozicion, si dhe eliminimin e dobësive të institucionit dhe shmangien e risqeve potenciale. Metoda e përdorur për të vlerësuar riskun në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, lidhet me analizimin e faktorëve potencialë të riskut me të cilat përballlet institucioni, me ndikim të brendshëm nga proceset e punës, por edhe nga faktorë të jashtëm. Në vlerësim të riskut potencial është aplikuar analiza SWOT (Fuqitë-Dobësitë-Mundësitë-Risqet), ku janë ndërlidhur kapacitetet e brendshme dhe mangësitë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me kërkesat dhe sfidat e jashtme me të cilat mund të përballlet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Zbatimi i planit strategjik dhe planit të veprimit 2020-2022 do të sigurohet nëpërmjet një sistemi monitorimi dhe vlerësimi lidhur me zbatimin e objektivave, masave apo aktiviteteve të planifikuara.

Procesi i monitorimit dhe i vlerësimit do të realizohet nga ana e strukturave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet monitorimit në vazhdimësi të nivelit të zbatimit të planit strategjik në përputhje me afatet e parashikuara në planin e veprimit; raportimin periodik mbi nivelin e zbatimit të secilit aktivitet/masë sipas fushës së veprimtarisë së secilës njësi organizative të Zyrës së ILD; bashkërendimin e aktiviteteve dhe strukturave përkatëse në rastet e vonesave apo mos zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara, si dhe harmonizimin me dokumentet e tjerë strategjik dhe burimet financiare të parashikuara për periudhën 2020-2022.

Ndërsa raportimi i zbatimit të planit të veprimit do të realizohet në baza periodike 3 – mujore bazuar në raportet e strukturave (*njësive organizative*) të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim ngritjen e një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit nga të gjitha njësitë organizative të përfshira në zbatimin e planit strategjik dhe planit të veprimit.

KREU II - ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

1. SITUATA AKTUALE

Përmes miratimit të ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, Republika e Shqipërisë ka filluar zbatimin e reformës në drejtësi. Ndryshimet kushtetuese parashikojnë, përveç organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, krijimin e një strukture të unifikuar inspektimi (Inspektori i Lartë i Drejtësisë) përgjegjës për të verifikuar ankesat, hetuar shkeljet, dhe për të filluar procedimin disiplinor, ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe prokurorive. Ky sistem do të zëvendësojë sistemin e mëparshëm të trefishtë të inspektimit që realizohej nën përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese, Kuvendi vijoi me miratimin e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, akte të cilat ofrojnë një kuadër ligjor të plotë dhe gjithpërfshirës për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në këto akte ligjore përcaktohen qartë parimet, të cilat duhet të udhëheqin sistemin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë. Sistemi i drejtësisë duhet të jetë i pavarur ndaj çdo lloji ndikimi, i paanshëm në funksionimin e tij, i përgjegjshëm, llogaridhënës, me integritet të lartë moral dhe profesional në të gjitha nivelet strukturore të tij, eficient dhe profesional, i besueshëm, transparent dhe i aksesueshëm prej publikut, si dhe bashkëpunues në nivel institucional kur ushtrohet pushteti vendimmarrës për emërimin e funksionarëve të lartë të sistemit.

Paketa e dy akteve ligjore të reformës në drejtësi solli disa risi thelbësore në drejtim të:

- a) Ndarjes së procesit të inspektimit nga procesi vendimmarrës për dhënien e masës disiplinore;
- b) Zgjidhjes së problematikës së kompetencës ekskluzive të ministrit të Drejtësisë për fillimin e procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve duke ia lënë këtë kompetencë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe duke i rezervuar edhe ministrit të drejtën t'i kërkojë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë fillimin e hetimit ndaj një apo më shumë gjyqtarëve të veçantë në lidhje me akuzat për shkelje disiplinore.
- c) Garantimit të një procedure transparente dhe të drejtë, për emërimin e inspektorëve magjistratë dhe jomagjistratë;
- d) Detajimit të shkeljeve disiplinore të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët dhe sanksionet proporcionale në përputhje me shkeljet, duke e orientuar sistemin e përgjegjësisë disiplinore mbi kritere sa më objektive;
- e) Sanksionimit të një sistemi të procedimit disiplinor që parashikon mekanizma që garantojnë parimin e një procesi të rregullt ligjor në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në mbështetje të nenit 147/d e vijues, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kreut IV, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 2/2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për zgjedhjen e Zotit Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë” nga data 01.02.2020, është krijuar Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Bazuar në të gjithë veprimtarinë dhe punën e kryer deri tani, konstatohet se në funksion të përmbushjes së detyrave të tij kushtetuese, veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është fokusuar fillimisht në organizmin dhe funksionimin e brendshëm të tij, si në aspektin administrativ ashtu edhe atë rregullator.

Në kuadër të fillimit të veprimtarisë, për periudhën shkurt-nëntor 2020, janë plotësuar vendet vakante, ku janë plotësuar pjesërisht vende vakante pranë kabinetit, vendet vakante të shërbimit civil dhe të punonjësve mbështetës. Sa i takon plotësimin të pozicioneve të inspektorëve, aktualisht pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezulton i plotësuar vetëm një pozicion i plotësuar, ndërkohë që mbeten për t’u plotësuar edhe pozicionet e tjera, sipas strukturës organizative. Paralelisht në periudhën mars 2020¹, kanë filluar shpalljet për vendet vakante për rekrutimin inspektorëve jomagjistratë, procedura të cilat deri në momentin e hartimit dhe miratimit të këtij plani, janë ende në vazhdimësi.

Në të njëjtën kohë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në cilësinë e autoritetit shtetëror përgjegjës për zhvillimin e hetimit disiplinor dhe nisjen e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve, krahas hartimit të akteve të nevojshme nënligjore, është në proces administrimi dhe shqyrtimi fillestar të një numri të madh ankesash lidhur me veprimtarinë e magjistratëve, të ardhura nga momenti i krijimit, por edhe të ankesave të depozituara pranë institucioneve të tjera para fillimit të veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Gjatë kësaj periudhe, prioritet i punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka qenë edhe shqyrtimi dhe vlerësimi me seriozitet i të gjitha çështjeve të cilat kanë pasur një impakt publik.

Konkretisht, për periudhën shkurt- tetor 2020, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë depozituar 2945 ankesa² të cilat kanë qenë depozituar në institucionet ekzistuese para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2020, si edhe pranë institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016 dhe konstituimit respektiv të tyre, përmendim këtu ankesa të marra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë, Presidenti i Republikës, Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, gjykata, bashki, organizata, ankesa qytetarësh etj.

¹<https://www.ild.al/wp-content/uploads/2020/02/SHPALLJE-PE%CC%88R-PRANIM-TE%CC%88-DREJTPE%CC%88RDREJTE%CC%88-INSPEKTORE%CC%88-1.pdf>

²Ndarja me statistikore e ankesave të ardhura:

- 757 ankesa të marra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si ankesa të mbartura;
- 185 ankesa të depozituara nga institucione të tjera (KLP, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë, Presidenti i Republikës, SPAK, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, gjykata, bashki etj);
- 9 ankesa nga organizata;
- 647 ankesa nga qytetarët, ku janë përfshirë edhe ankesat

Pas marrjes së ankesave në dorëzim, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vijuar me konfirmimet³ përkatëse, në zbatim të ligjit, nga ku rezulton se për periudhën shkurt- tetor 2020, janë kryer 841 konfirmime.

Lidhur me shqyrtimin e ankesave gjatë periudhës shkurt- tetor 2020, janë miratuar 210⁴ vendimet përkatëse. Njëkohësisht zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon punën me kapacitet aktuale të burimeve njerëzore dhe ka filluar trajtimin e ankesave duke ngritur grupe pune për trajtimin e tyre me përparësi.

Në zbatim të parashikimeve ligjore janë filluar hetimet për shkeljet disiplinore, ku disa prej tyre janë me iniciativë të vetë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe një pjesë e tyre janë mbi bazë ankese⁵.

Krahas verifikimeve të ankesave, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen dhe inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve, ku Inspektori i Lartë ka ndërmarrë edhe inspektime tematike pranë gjykatave dhe prokurorive për kërkesat me objekt “Lirim me kusht”⁶

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pavarësisht sfidave të hasura që në fillimin e punës së tij, si mungesa e burimeve njerëzore dhe situata e shkaktuar nga pandemia, ka nisur tashmë përbushjen e një pjese të konsiderueshme të detyrimeve ligjore, të cilat do të finalizohen në përputhje me afatet e Planit të Veprimit.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë periudhës në vazhdim do ketë si objektiv kryesor ushtrimin e veprimtarisë së tij në mënyrë të pavarur, eficiente, profesionale, si dhe sa më transparente dhe të besueshme ndaj publikut. Në të njëjtën kohë, do të synohet rritja e standardeve me qëllim zhvillimin e procesit hetimor disiplinor në përputhje me parimet e ligjshmërisë e të procesit të rregullt ligjorsipas standardeve ndërkombëtare duke garantuar pjesëmarrjen aktive në proceset e planifikimit strategjik dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

³Për periudhën shkurt- tetor 2020, janë kryer:

- 647 konfirmime mbi ankesat e depozituara nga qytetarët;
- 185 konfirmime mbi ankesat e depozituara nga institucione të tjera;
- 9 konfirmime mbi ankesat e ardhura nga organizatat.

⁴- 68 vendime për arkivim të ankesave pas shqyrtimit fillestar;

- 68 njoftime për vendimearkivimi të ankesave;

- 28 vendime për verifikim të ankesave pas shqyrtimit fillestar;

- 40 kërkesa drejtuar gjykatave apo prokurorive, mbi informacione ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve të kërkuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në kuadër të verifikimit të ankesave;

- 6 vendime për fillimin e hetimit disiplinor

⁵ 2 vendime të fillimit të hetimit me iniciativë të ILD-së janë për një magjistrat dhe një prokuror, ndërsa 4 vendime të tjera janë për 3 gjyqtarë dhe 1 prokuror të filluara me ankesë të subjekteve të parashikuara në ligj.

⁶ janë miratuar:

- Vendim Nr. 1 datë 11.02.2020, “Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt “Lirim me Kusht”;

- Vendim Nr. 1/1 datë 20.02.2020 “Për shtimin e objektit të inspektimit tematik të caktuar me vendimin nr. 1 datë 11.02.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

Ngritja dhe funksionimi i këtij institucioni të ri kushtetues duhet të realizohet nëpërmjet një Sistemi Planifikimi të Integruar (SPI), si dhe sigurimit të një sërë mekanizmash të përshtatshëm të qeverisjes, monitorimit, raportimit, metodave dhe treguesve (indikatoreve) të mirëpërcaktuar, së bashku me mbështetjen e duhur financiare për zbatimin e tyre. Ky proces, kërkon një qasje ndërsektoriale, sa më gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar.


2. VLERËSIMI I RISKUT

Procesi i hartimit të strategjisë dhe planit të veprimit është realizuar duke mbajtur në konsideratë kombinimin e përparësive me mundësitë që institucioni ka në dispozicion, si dhe eliminimin e dobësive të institucionit dhe shmangiene risqeve potenciale.

Metoda e përdorur për të vlerësuar riskun në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, lidhet me analizimin e faktorëve potencialë të riskut me të cilat përballet institucioni, me ndikim të brendshëm nga proceset e punës, por edhe nga faktorë të jashtëm.

Në vlerësim të riskut potencialë është aplikuar analiza SWOT (Fuqitë-Dobësitë-Mundësitë-Risqet), ku janë ndërlidhur kapacitetet e brendshme dhe mangësitë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me kërkesat dhe sfidat e jashtme me të cilat mund të përballet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Në këto kushte Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë hartimit të këtij plani strategjik, në parashikimin e objektivave të tij ka zhvilluar këtë analizë, e cila është pasqyruar në grafikun e mëposhtëm:



Në analizën e riskut (Aneksi bashkëlidhur planit të veprimit), është parashikuar edhe matrica përkatëse e vlerësimit të tij e cila është përgatitur sipas riskut të identifikuar nga dobësitë dhe kërcënimet e mundshme në rast të mos arritjes së objektivave, duke përfshirë një vlerësim të probabilitetit të ndodhjes së riskut, ndikimin e mundshëm të rrezikut si dhe propozimin për veprime lehtësuese për të shmangur ndodhjen e rrezikut ose për ta zbutur atë nëse ndodh.

3. LIDHJA ME DOKUMENTE TË TJERË STRATEGJIKË

Plani strategjik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është hartuar në përputhje me kornizën e Sistemit të Planifikimit të Integruar, duke u bazuar në koordinimin midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave që përfshihen në SKZHI, si dhe duke zbatuar një qasje sistematike dhe të integruar në zhvillimet e procesit të Integritimit Evropian, në kërkesat e Programit Buxhetor Afatmesëm, në programin e investimeve publike dhe atë të ndihmës së huaj.

Plani përputhet me objektivat afatmesme dhe afatgjata të qeverisjes, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020^[7], si dhe Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë^[8]. Në të njëjtën kohë, përmbajtja e këtij Plani Strategjik është konceptuar edhe në përputhje me objektivat dhe një sërë masash të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2023^[9], si dhe në Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP) 2015-2020 ^[10].

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 në kuadër të konsolidimit të pavarësisë dhe efikasitetit të gjyqësorit ka parashikuar ndër të tjera se ky objektiv duhet të arrihet përmes:

- Rishikimit të rregullt të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë analizën e hendeqeve dhe identifikimin e fushave që kanë nevojë për përmirësime;
- Zbatimin të legjislacionit krahas masave që do të rrisin pavarësinë, efikasitetin, integritetin dhe llogaridhënien e gjyqësorit në të gjitha nivelet e sistemit;
- Mekanizmave më të fortë të kontrollit brenda sistemit gjyqësor të lidhura me statusin dhe aftësitë profesionale të inspektorëve dhe metodat e verifikimit.

Rritja e transparencës dhe konsolidimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë do të arrihet nëpërmjet rritjes së profesionalizmit dhe përmbushjes së detyrave përmes inspektimeve të gjykatave/prokurorive, si dhe krijimit të mundësive të publikut për t'u njohur me kuadrin ligjor. Këto parashikime janë mbajtur në konsideratë, gjatë vendosjes së objektivave strategjik dhe specifik në këtë dokument.

Në të njëjtën kohë, në kuadër të bashkërendimit të këtij plani me strategjitë e sektorëve të tjerë, është mbajtur në konsideratë përputhshmëria me parashikimet e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë¹¹.

Me qëllim zbatimin e suksesshëm të reformave në sistemin e drejtësisë, për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent, në përputhje me praktikën më të mira evropiane, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë parashikon ndër të tjera edhe këto objektiva strategjike të nivelit të lartë:

[7] Miratuar me Vendimin Nr. 348, datë 11.5.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 - 2020”.

[8] Miratuar me Vendimin Nr. 773, datë 2.11.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planin e saj të Veprimit”.

[9] Miratuar me Vendimin Nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020”, i ndryshuar.

[10] Miratuar me Vendimin Nr. 319, datë 15.04.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike (SNRAP) 2015-2020”.

¹¹ Gjatë fazës së hartimit të planit strategjik dhe planit të veprimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është duke u hartuar edhe Strategjia e re Ndërsektoriale e drejtësisë. Për këtë qëllim referimi I bërë në këtë dokument I referohet strategjisë së miratuar me vendimin nr. 763/2016 të Këshillit të Ministrave dhe Koncept dokumentit të përcjellë nga Ministria e Drejtësisë, I aksesueshëm datë 13.11.2020, në linkun

<http://drejtesia.gov.al/newsroom/lajme/koncept-dokumenti-strategjik-per-snd-ne/>

- Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë;
- Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen e tij në përputhje me standardet evropiane;
- Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar sisteme moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit ndërinstitucional;
- Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut;
- Përmirësimi i funksionimit të organeve të sistemit të drejtësisë.

Objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë organizuar dhe ndarë në nën-objektiva për të bërë të mundur një organizim më të mirë dhe të drejtpërdrejtë të masave të parashikuara dhe të lidhura me to, për sa më poshtë:

- Përmirësimi i llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas standardeve evropiane;
- Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane;
- Përmirësimi i funksionimit të gjyqësorit përmes krijimit të sistemeve IT të administrimit dhe përmirësimeve të tjera në infrastrukturë;
- Përmirësimi i funksionimit të organeve të reja të sistemit të drejtësisë të krijuara rishtazi apo tërësisht të ndryshuara.

Planifikimi i këtyre nën-objektivave synon të intensifikojë organizimin dhe funksionimin e organeve të reja të sistemit të drejtësisë ku përfshihet edhe Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në të njëjtën kohë përparësi i jepet përmirësimit infrastrukturor të organeve të sistemit të drejtësisë përmes ngritjes, funksionimit dhe administrimit të sistemeve TI. Organet e reja të sistemit të drejtësisë parashikohen të jenë të pajisura me kushte dhe mjete pune të standardeve më të larta, të cilat do të garantojnë funksionimin normal të tyre.

Njëkohësisht janë parashikuar një sërë masash konkrete në drejtim të zhvillimit strukturor, organizativ dhe përmirësimit të kapaciteteve njerëzore e profesionale për të bërë të mundur zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga strategjia.

Në zbatim të këtyre nën-objektivave, janë parashikuar ndër të tjera një sërë masash dhe aktiviteteve, të cilat lidhen me organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përputhje me standardet evropiane. Këto parashikime janë mbajtur në konsideratë edhe gjatë konceptimit të masave dhe aktiviteteve në kuadër të këtij plani strategjik.

Për sa i përket transparencës dhe rritjes së aksesueshmërisë ndaj veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë parashikuar një sërë masash dhe aktiviteteve, të cilat lidhen

me rritjen e transparencës, sigurimin e aksesit të publikut tek informacioni në rastet e interesit publik, përmirësimin e marrëdhënieve me median.

Për sa i përket aplikimit të sistemeve TI, të administrimit dhe përmirësime të tjera në infrastrukturë, janë parashikuar masa dhe aktivitete të cilat lidhen me përmirësimin e funksionimit të Zyrës Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Konkretisht në mënyrë që të sigurohet forcimi dhe realizimi i objektivave të ILD-së është parashikuar të sigurohet dhe të jetë funksional edhe infrastruktura e nevojshme e TI-së. Për këtë qëllim përfshirja e masave konkrete për zhvillimin e teknologjisë, duke filluar me pajisjen e infrastrukturës së nevojshme që ka të bëjë me zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, i cili do të jetë një sistem bashkëkohor me synimin për të dixhitalizuar dokumentacionin e arkiv-protokollit, mbledhjen dhe analizën e provave dhe procedimin i ankesës në mënyrë dixhitale.

Sistemi i menaxhimit të çështjeve mundëson mbledhjen e të dhënave, gjenerimin e raporteve, ndërlidhjen me sisteme të tjera komunikimi elektronik dhe nxitjen e pyetjeve të sofistikuara për mbledhjen e të dhënave, duke përmirësuar kështu efikasitetin e organizimit dhe funksionimit.

Përveç sa më sipër, janë parashikuar ndër të tjera një sërë masash dhe aktiviteteve, të cilat lidhen me përmirësimin e funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke siguruar hartimin dhe zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, integritetin dhe përgjegjshmërinë në menaxhimin operacional, me qëllim garantimin e përmbushjes me efikasitet dhe efektivitet të përgjegjësive dhe kompetencave kushtetuese të këtij institucioni.

Në kuadër të objektivave specifike të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i lind detyrimi të marrë një sërë masash me synim rritjen e transparencës në raport me veprimtarinë e tij, si dhe përmirësimin e aksesit të qytetarëve në informacion. Ky synim është parashikuar të arrihet nëpërmjet krijimit të strukturave të nevojshme për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, zbatimit të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe planifikimit të aktiviteteve të ndryshme me qëllim informimin dhe vënien në dispozicion të publikut, nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të të gjitha akteve nënligjore që parashikojnë procedurat e trajtimit të ankesave, afateve të paraqitura pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sidhe formularit për ankesat.

Për sa i përket përmirësimit të efikasitetit, kontrollit, inspektimit dhe përdorimit sistematik të analizave të riskut janë parashikuar një sërë masash, të cilat pasqyrojnë zbatimin e njëplani të përgjithshëm, organizativ, strukturor, infrastrukturor apo metodave të punës mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave funksionale të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilat kanë të bëjnë me verifikimin, hetimin apo zhvillimin e inspektimeve tematike apo institucionale. Kjo është planifikuar të zhvillohet nëpërmjet një qasje parandaluese, ndërgjegjësuese, mbikëqyrëse, apo ndëshkuese. Në të njëjtën kohë është synuar ngritja dhe rritja e kapaciteteve të strukturës së

auditit të brendshëm, e cila do të garantojë efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në institucion.

Gjithashtu në kuadër të forcimit të integritetit të stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë parashikuar një sërë masash të cilat kanë të bëjnë me rritjen e kapaciteteve të stafit për sistemin e testimit të integritetit, zbatimin e procedurave të testimit të integritetit në mënyrë të vazhdueshme, si dhe përfshirja e pyetjeve që lidhen me integritetin në testimet për rekrutimin e administratës apo përfshirja e këtyre kriterëve për pozicionet e punës.

Ndërsa në kuadër të rritjes së transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve buxhetore, në funksion të garantimit të transparencës janë parashikuar një sërë masash të cilat kanë të bëjnë me publikimin në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të fondeve buxhetore të akorduar në zbatim të ligjit vjetor të buxhetit dhe procedurave të prokurimit publik të kryera nga ky institucion.

Në kuadër të objektivave specifike të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015-2020, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i lind detyrimi të marrë një sërë masash me synim zhvillimin e politikave planifikuese dhe koordinuese me qëllim përmirësimin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të dokumenteve strategjike nëpërmjet mbledhjes së të dhënave, hartimin dhe zbatimin e legjislacionit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe fuqizimi i strukturave të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut, si dhe zhvillimi i një infrastrukture TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kjo është parashikuar të realizohet nëpërmjet aplikimit të metodave të punës dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacionin, me qëllim përmirësimin e rrjedhës së informacionit përgjatë punës së përditshme.

Gjithashtu me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale nëpërmjet masave të parashikuara synohet qëndrueshmëria, profesionalizmi i administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, zbatimi me rigorozitet i legjislacionit për kryerjen e procedurave të rekrutimit, si dhe rritja e përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Krahas qasjes koordinuese me këto dokumente strategjike, plani strategjik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mban në konsideratë edhe një grup parimesh funksionale me qëllim përmbushjen e standardeve lidhur me procesin e integritetit evropian. Kjo është realizuar nëpërmjet kombinimit të veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me atë të proceseve integruese të vendit duke bërë të mundur, për sa diktohet edhe në progres-raportin e Komisionit Evropian për vitin 2020, sjelljen e rezultateve konkrete dhe të besueshme me qëllim forcimin dhe konsolidimin e pavarësisë, paanësisë, profesionalizmin nëpërmjet rritjes së

kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të verifikuar dhe hetuar në mënyrë efektive numrin e madh të backlog-ut (ankesave të mbartura) në funksion të garantimit të llogaridhëniessë sistemit të drejtësisë.

Zbatimi i planit strategjik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është mbështetur nga burime financiare, të cilat janë përlogaritur duke iu referuar buxhetit afatmesëm të shtetit, të alokuar në PBA 2020-2022¹² dhe në PBA 2021-2023¹³, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, në përlogaritjen e nevojave financiare janë marrë në konsideratë edhe projektet me financim të huaj (në vijim ose të planifikuara) në fushën e drejtësisë.

KREU III –VIZIONI, MISIONI,VLERAT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Vizioni:

Sistemi i drejtësisë duhet të jetë i pavarur ndaj çdo lloj ndikimi, i paanshëm në funksionimin e tij, i përgjegjshëm, llogaridhënës, me integritet të lartë moral dhe profesional në të gjitha nivelet strukturore të tij, eficient dhe profesional, i besueshëm, transparent dhe i aksesueshëm prej publikut, si dhe bashkëpunues në nivel institucional.

Misioni:

Inspektorii i Lartë të Drejtësisë ka për mision vendosjen e standardeve mbi mënyrën e verifikimit të ankesave, trajtimit të tyre në një kohë sa më të shpejtë me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve në ushtrimin e detyrës nga njëra anë dhe motivimin e rritjen e besimit të qytetarëve dhe organeve që ligji u njeh të drejtën e paraqitjes së ankesave, ndaj sistemit gjyqësor, nga ana tjetër.

Vlerat:

Paanshmëria: Inspektorët duhet të jenë të paanshëm dhe t'i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe kompetencave të dhëna me ligj, në kryerjen e verifikimeve, hetimeve administrative dhe inspektimeve.

Integriteti: Inspektorët gjatë ushtrimit të detyrës duhet të shfaqin integritet të lartë duke shmangur sjellje të pahijshme që mund të cënojnë figurën e institucionit apo besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Profesionalizimi dhe kompetenca: Inspektorët duhet të tregojnë dhe të promovojnë standarde të larta të njohurive profesionale dhe etikës, me qëllim për të forcuar besimin e publikut.

Llogaridhënia: Inspektorët do t'i nënshtrohen një regjimi mbikëqyrje, drejtimi, përgjegjshmërie dhe disipline nga organi më i lartë.

¹²VKM nr. 845, datë 24.12.2019 “Për miratimin e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, të rishikuar”.

¹³VKM nr. 577, datë 22.07.2020 “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023”

QASJA E PËRGJITHSHME PËR OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Në bazë të vlerësimeve dhe analizës së situatës të paraqitur mësipër, plani strategjik dhe qëllimet strategjike gjenden të përcaktuara në katër objektiva të përgjithshëm, ku secili prej tyre përcakton qëllimine përgjithshëm, i zbërthyer në objektiva specifike me një përshkrim të rezultateve të pritshme, që do të arrihen gjatë periudhës së strategjisë bashkë me treguesit përkatës, të cilët do të shërbejnë si tregues të qartë (cilësorë dhe sasiorë) në drejtim të vlerësimit të arritjes së secilit objektiv strategjik.

Objektivi Strategjik 1: Fuqizimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mënyrë të pavarur, efçente dhe profesionale.

- Objektivi Specifik 1.1: Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet sigurimit të mjediseve, pajisjeve dhe kushteve të punës.

Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik konsiston në sigurimin e mjediseve të punës me qëllim fillimin e veprimtarisë pas miratimit të vendimi nr. 507, datë 24.06.2020 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë të godinës së ish-Ministrit të Integritit Evropian”, planifikimi i përshtatjes së mjediseve në ambientet të përshtatshme pune dhe furnizimi me bazë logjistike për ushtrimin e detyrave funksionale për punonjësit e ILD-së.

- Objektivi Specifik 1.2: Sigurimi i autonomisë financiare dhe administrative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik konsiston në plotësimin e vakancave në institucion me qëllim përgatitjen dhe hartimin e kërkesave të nevojshme buxhetore.

- Objektivi Specifik 1.3: Përmirësimi i menaxhimit dhe komunikimit të brendshëm organizativ të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik konsiston në përgatitjen e përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet sipas strukturës organizative, hartimi i rregullave bazë të funksionimit të institucionit, komunikimit të brendshëm, njehsimit të dokumenteve dhe përcaktimi i rregullave për përdorimin e sistemeve elektronike të ILD-së.

- Objektivi Specifik 1.4: Zhvillimi i sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik konsiston në hartimin e projektit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, krijimi i infrastrukturës bashkëkohore elektronike për sigurimin e ndërlidhjes me sistemet e tjera, pajisja me programe

dhe pajisje për menaxhimin e dokumentacionit, mbledhja e të dhënave dhe gjenerimin e raporteve, mundësimi i trajnimeve specifike për përdoruesit e sistemeve..

- **Objektivi Specifik 1.5:** Rritja e njohurive dhe aftësive profesionale të inspektorëve dhe nëpunësve civilë, nëpërmjet ofrimit të mundësive të vazhdueshme për zhvillim profesional, në mënyrë që secili prej tyre, në pozicionin përkatës, të përmbushë në mënyrë efikente detyrat e tij funksionale.

Rezultati i pritshëm për këtë objektivi specifik konsiston në rritjen e kapaciteteve të burime njerëzore në bashkëpunimin mes institucioneve shtetërore apo ekspertëve të huaj me qëllim konceptimin e kurrikulave të trajnimit në kryerjen e detyrave funksionale.

- **Objektivi Specifik 1.6:** Ngritjen e një sistemi efektiv, transparent dhe objektivi të vlerësimit të performancës së inspektorëve.

Rezultati i pritshëm për këtë objektivi specifik konsiston në ngritjen e strukturave të brendshme për kriteret dhe vlerësimin e kandidatëve jomagjistratë dhe rregullave për vlerësimin e performancës dhe rezultateve në punë të inspektorëve.

Objektivi Strategjik 2: Zhvillimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare.

- **Objektivi Specifik 2.1:** Krijimi i bazës për interpretimin dhe zbatimin e duhur të kuadrit ligjor që ka të bëjë me përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve.
Rezultati i pritshëm për këtë objektivi specifik konsiston në hartimin e dokumenteve mbështetëse për inspektorët dhe sigurimi i zbatimit në mënyrë të njëtrajtshme të legjisllacionit për përgjegjësinë disiplinore të magjistratit.

- **Objektivi Specifik 2.2:** Standardizimi/Unifikimi i metodave dhe proceseve të punës për trajtimin e ankesave apo zhvillimin e veprimtarisë inspektuese dhe hetimore.

Rezultati i pritshëm për këtë objektivi specifik konsiston në miratimin e rregullave për trajtimin e ankesave.

- **Objektivi Specifik 2.3:** Përqasja e metodave/proceseve të punës me Standardet Ndërkombëtare për hetimin disiplinor dhe inspektimin.

Rezultati i pritshëm për këtë objektivi specifik konsiston në miratimin e rregullave standarde për inspektimin në përputhje me standardet ndërkombëtare.

- **Objektivi Specifik 2.4:** Rritjen e numrit të ankesave të trajtuara brenda afateve ligjore.

Rezultati i pritshëm për këtë objektivi specifik konsiston në marrjen e masave për trajtimin e ankesave të përcjella nga institucionet përpara periudhës tranzitore si

edhe marrjen e masave të brendshme organizative për të rritur numrin e trajtimit të ankesave në mënyrë progresive.

Objektivi Strategjik 3: Pjesëmarrje aktive në proceset e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

- Objektivi Specifik 3.1: Zhvillimi i një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit nga të gjitha njësitë organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për hartimin, monitorimin dhe raportimin në kuadër të bashkëpunimit me institucione të tjera.

Rezultati i pritshëm për këtë objektivi specifik konsiston në përcaktimin e mënyrës së ndjekjes dhe monitorimit të brendshëm të raportimit nga njësitë raportuese.

- Objektivi Specifik 3.2: Ndjekja/realizimi i aktiviteteve që Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë ka parashikuar për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
Rezultati i pritshëm për këtë objektivi specifik konsiston në ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë.

Objektivi Strategjik 4: Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në Institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

- Objektivi Specifik 4.1: Rritja e aksesit të publikut përmes komunikimit dhe bashkëpunimit me qytetarët.

Rezultati i pritshëm për këtë objektivi specifik konsiston në përgatitjen e formularit të detajuar dhe udhëzuesit për plotësimin e tij në mënyrë që paraqitja e ankesës të jetë e qartë dhe e lehtë për t'u plotësuar.

- Objektivi Specifik 4.2: Zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit me qëllim bashkëpunimin me publikun, si dhe rritjen e transparencës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Rezultati i pritshëm për këtë objektivi specifik konsiston në rritjen e numrit të vizitorëve të faqes, përmes së cilës do të bashkëpunohet me publikun në thjeshtimin e komunikimit.

- Objektivi Specifik 4.3: Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit nga inspektorët.

Rezultati i pritshëm për këtë objektivi specifik konsiston në ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjësuese për publikun.

KREU IV - BURIMET FINANCIARE

1. BUXHETI I SHTETIT

Procesi i kostimit është bazuar në konsultimin e dokumenteve kombëtare, përfshirë këtu ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2021 - 2023, si dhe konsultimet me aktorët e përfshirë në hartimin e këtij plani strategjik. Është synuar që nëpërmjet këtij procesi të evitohen mbivendosjet financiare në dokumentet e tjerë strategjike, si dhe plani i veprimit është shoqëruar me një kostim analitik të secilës masë.

Shpërndarja e burimeve financiare që financojnë aktivitetet e planit të veprimit në zbatim të këtij plani strategjik, do të parashikohet sipas viteve buxhetore për secilin, objektiv strategjik dhe objektiv specifik dhe aktivitet.

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e këtij plani strategjik dhe planit të veprimit për vitin 2020-2022 është 192 milionë e 570 mijë lekë.

Financimi i planit të veprimit të këtij plani strategjik do të realizohet, nga buxheti i shtetit dhe nga mbështetja financiare e komunitetit të donatorëve e cila pritet të realizohet, nëpërmjet marreveshjeve me donatorët.

Plani i veprimit do të rishikohet në bazë vjetore për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhornuar atë konform ciklit të programimit vjetor buxhetor. Për masa të planit të veprimit ende të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të Programit Afatmesëm Buxhetor dhe buxhetit vjetor.

Gjithashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë do të identifikojë me komunitetin e donatorëve mundësitë për mbështetje financiare të nevojshme për ato masa, të cilat aktualisht nuk janë të mbuluara financiarisht.

KREU V - MONITORIMI DHE RAPORTIMI

1. MONITORIMI

Zbatimi efikas i planit strategjik dhe planit të veprimit 2020-2022, i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të sigurohet nëpërmjet një sistemi monitorimi dhe vlerësimi lidhur me zbatimin e objektivave, masave apo aktiviteteve të planifikuara. Ky proces do të bëjë të mundur rishikimin e objektivave, masave apo aktiviteteve, si dhe shpërndarjen e burimeve financiare.

Procesi i monitorimit dhe i vlerësimit do të realizohet nga ana e strukturave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet monitorimit në vazhdimësi të nivelit të zbatimit të planit strategjik në

përputhje me afatet e parashikuara në planin e veprimit; raportimin periodik mbi nivelin e zbatimit të secilit aktivitet/masë sipas fushës së veprimtarisë së secilës njësi organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; bashkërendimin e aktiviteteve dhe strukturave përkatëse në rastet e vonesave apo mos zhvillimit të aktiviteteve të planifikuara, si dhe harmonizimin me dokumentet e tjerë strategjik dhe burimet financiare të parashikuara për periudhën 2020-2022.

Plani i veprimit që është pjesë e këtij dokumenti strategjik, do të jetë objekt i rishikimit periodik vjetor, proces i cili do të realizohet me kontributin e të gjithë strukturave përbërëse të institucionit, nën koordinimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve dhe Shërbimeve Juridike për të siguruar një vlerësim sa më realist të zbatimit të tij, si dhe për të pasqyruar ndryshimet dhe ecurinë e veprimtarisë së këtij institucioni drejt arritjes së objektivave strategjik dhe atyre specifik të parashikuar paraprakisht.

2. RAPORTIMI

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, brenda një muaji nga miratimi i planit strategjik dhe planit të veprimit do të përcaktojë një sistem raportimi, i cili do të ofrojë një informacion periodik në lidhje me ecurinë e zbatimit të aktiviteteve.

Raportimi i zbatimit të planit të veprimit do të realizohet në baza periodike 3 – mujore bazuar në raportet e strukturave (*njësive organizative*) të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim ngritjen e një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit nga të gjitha njësitë organizative të përfshira në zbatimin e planit strategjik dhe planit të veprimit.

PLANI I VEPRIMIT 2020-2022

Objektivi Strategjik 1: Fuqizimi dhe ushtrimi i veprimitarisë së ILD-së në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesional.									
<i>Objektivi Specifik 1.1 Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet sigurimit të hapësirave mjediseve, pajisjeve dhe kushteve të punës.</i>									
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Struktura Përgjegjëse	Afati i realizimit	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2020		Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2021		Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2022		Treguesi cilësor/sasior
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	
Sigurimi i ambjenteve (selia e ILD) të nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe zbatimin e objektivave ligjore	ILD	Gusht 2020 ne vijim	1,184		8,124		8,124		1. Godinë 2. Numër të mjaftueshëm zyrash për 93 punonjës 3 Ambiente pune, sallë mbledhje
Rikonstruksioni i ambienteve të brendshme për pajisjen me ambiente pune për të gjithë numrin e punonjësve, sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 28/2020.	Sekretari i Përgjithshëm dhe DESHM	Dhjetor 2021			20,000				Realizimi i projektit/ Përfundimi i zbatimit të projektit

Sigurimi i ambjenteve te posaçme me standartet teknike per pajisjet e zhvillimit te teknologjisë së Informacionit (dhome e pavarur serveri), në përputhje me standartet Europiane	Sekretari i Përgjithshëm DESHM/ Sektori IT	Dhjetor 2021			2,687				Realizimi i projektit/ Përfundimi i zbatimit të projektit, me ngritjen e dhomës së serverit.
Zhvillimi i sistemit per lidhjen me rrjetin “Portën Qeveritare” qe mundeson hyrjen në Sistemet IT të institucioneve të drejtësië, KLGJ/KLP të nevojshme për punën e ILD.	Sekretari i Përgjithshëm DESHM / Sektori IT	Dhjetor 2021			1,109				Vendosja e komunikimit me sistemet IT
Pajisja e punonjësve me bazën logjistike të nevojshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj.	Sekretari i Përgjithshëm	Dhjetor 2020 Mars 2021 Mars 2022	6,911		32,000		2,000		Pajisje informatike si PC, UPS , printera, skaner, fotokopje,si dhe pajisje e orendi zyre per punonjesit e rekrutuar
Planifikimi i bazës logjistike të nevojshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, për numrin e përgjithshëm të punonjësve të miratuar sipas strukturës dhe	Sekretari i Përgjithshëm	Dhjetor 2020 Mars 2021 Mars 2022	3,833		19,526		6,876		% e buxhetit te shpenzimeve operative e dedikuar per sigurimin e logjistikes se nevojshme per stafin e rekrutuar nepermjet blerjeve te materialeve dhe sherbimeve te domosdoshme per kryerjen e funksioneve

organikës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 28/2020									
<i>Objektivi Specifik 1.2 Sigurimi i autonomisë financiare dhe administrative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</i>									
Plotësimi i vendeve vakante në Institucion	Sekretari i Përgjithshëm dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	2020-2021	2,179		1,597				Numri i punonjësve të plotësuar sipas strukturës
Hartimi i kërkesave buxhetore	Sekretar i përgjithshëm dhe DESHM	2020/2021/2022	1,159		2,293		2,293		% e kërkesave të përfshira në PBA-në e miratuar
<i>Objektivi Specifik 1.3 Përmirësimi i menaxhimit dhe komunikimit të brendshëm organizativ të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:</i>									
Përfundimi i përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet.	DPÇSHJ, në bashkëpunim me të gjitha strukturat përbërëse të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	Dhjetor 2020	274						Numri i përshkrimeve të punës
Hartimi i rregullores për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	DPÇSHJ, në bashkëpunim me Njësien e Inspektorëve	Dhjetor 2020	6,122						Nxjerrja e urdhrat për miratimin e rregullores
Njehsimi i dokumenteve administrative të nxjerra nga ILD.	DPÇSHJ	Shtator 2020	119						Nxjerrja e urdhrat për njehsimin e dokumentave

Hartimi i rregullores së roleve dhe perdorimit të sistemit	DPCSHJ	2020-2021	5,280		5,280				Nxjerrja e urdhrit për miratimin e rregullores së përdoruesve të sistemit
<i>Objektivi Specifik 1.4 Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</i>									
Hartimi i projektit/ termave të referencës të sistemit të menaxhimit të çështjeve	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me të gjitha strukturat dhe ekspertë të Huaj.	2021			938				Hartimi i projektit Zbatimi i projektit
Pajisja me software specifik për menaxhimin e dokumentacionit	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me TIK, dhe AKSHI-n.	2021							Pilotimi i software Instalimi i softëare
Trajnime specifike për përdoruesit e sistemit		2021							Numri i trajnimeve të kryera
<i>Objektivi Specifik 1.5 Rritja e njohurive dhe aftësive profesionale të inspektorëve dhe nëpunësve civilë, në mënyrë që secili prej tyre, në pozicionin përkatës të përmbushë në mënyrë eficiente detyrat e tij funksionale.</i>									
Bashkëpunimi me ASPA, Shkollën e Magjistraturës dhe ekspertë të huaj për ofrimin e trajnimeve	DPCSHJ në bashkëpunim me Sektorin e burimeve njerëzore	Në vijimësi	26		26		26		Planifikimi dhe formalizimi i kërkesave për bashkëpunim
Ngritje e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve specifike për pozicionet e punës	ASPA, Shkollën e Magjistraturës dhe ekspertë të huaj	2021							Numri i trajnimeve për çdo sektor
Konceptimi i termave të trajnimit në bashkëpunim me Shkollën e	Shkolla e Magjistraturës dhe ekspertë të huaj	Në vijimësi	26		26		26		Hartimi i kurrikulave për çdo trajnim

Magjistraturës dhe ekspertë të huaj.									
Objektivi Specifik 1.6: Ngritjen e një sistemi efektiv, transparent dhe objektiv të vlerësimit të performancës së inspektorëve.									
Ngritja e Komitetit të emërimit dhe vlerësimit të performancës	ILD	Mars 2020	243						Numri i inspektorëve të vlerësuar
Hartimi i rregullave për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo magjistratë	ILD	Mars 2020	243						Hartimi i aktit për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo magjistratë
Hartimi i rregullores për vlerësimin e Inspektorëve	ILD	Mars 2021	1,885		5,655				Miratimi i rregullores
Objektivi Strategjik 2: Zhvillimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare.									
<i>Objektivi Specifik 2.1: Krijimi i bazës për interpretimin dhe zbatimin e duhur të kuadrit të ri ligjor që ka të bëjë me veprimtarinë lidhur me përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve.</i>									
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Struktura Përgjegjëse	Afati	Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2020		Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2021		Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2022		Treguesi cilësor/sasior
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	
Hartimi i manualit të hetimit disiplinor ku përfshihet edhe komentari i ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	DPÇSHJ, në bashkëpunim me inspektorët, ndihmësinpektorët, nën asistencën e ekspertëve të misionit	2021	26						Hartimi i aktit për miratimin e manualit

	EURALIUS V								
<i>Objektivi Specifik 2.2: Standardizimi/unifikimi i metodave dhe proceseve të punës për trajtimin e ankesave apo zhvillimin e veprimtarisë inspektuese dhe hetimore.</i>									
Hartimi i rregullores për trajtimin e ankesave.	DPÇSHJ, në bashkëpunim me inspektorët dhe asistencë të huaj	Janar 2021	5,098		1,020				Hartimi i aktit për miratimin e rregullave procedurale për trajtimin e ankesave
Hartimi i metodologjisë për inspektimin	DPÇSHJ, në bashkëpunim me inspektorët dhe asistencë të huaj	2021			6,118				Hartimi i aktit për miratimin e metodologjisë së inspektimit
<i>Objektivi Specifik 2.3 Përfaqja e metodave/proceseve të punës me standardet ndërkombëtare për hetimin disiplinor dhe inspektimin.</i>									
Analizim të dispozitave ligjore në raport me standardet ndërkombëtare	DPÇSHJ	Në vijimësi	878		878		878		Identifikimi i standardeve
Adresimi i nevojës për ndryshime ligjore	DPÇSHJ	Në vijimësi	2,634		2,634		2,634		Identifikimi i akteve për ndryshim
<i>Objektivi Specifik 2.4 Rritja e numrit të ankesave të trajtuara në përputhje me afatet ligjore</i>									
Ngritja e grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera, sipas objektit	DPÇSHJ dhe njësia e inspektorëve dhe ndihmësinspektorëve	Dhjetor 2020	579						Miratimi i Urdhrit “Për ngritjen e grupit të punës”
Hartimi i akteve nënligjore për trajtimin e posaçëm të ankesave të mbartura nga institucionet e tjera	DPÇSHJ dhe njësia e inspektorëve dhe ndihmësinspektorëve	Dhjetor 2020	234						Miratimi i Urdhrit “Për përcaktimin e rregullave për trajtimin e ankesave të mbartura”

Shqyrtimi me prioritet i ankesave sipas gjetjeve të grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera, sipas objektit	Njësia e Inspektorëve dhe Ndihmësinspektorëve	Mars 2021	6,072		4,048				Trajtimi cdo muaj i 20% të ankesave
---	---	-----------	-------	--	-------	--	--	--	-------------------------------------

Objektivi Strategjik 3: Pjesëmarrje aktive në proceset e koordinimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Objektivi Specifik 3.1: Zhvillimi i një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit nga të gjitha njësitë organizative të Zyrës së ILD për hartimin, monitorimin dhe raportimin në lidhje me proceset e planifikimit strategjik.

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Struktura Përgjegjëse	Afati	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2020		Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2021		Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2022		Treguesi cilësor/sasior
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	
Identifikimi i raporteve ku jep kontribut Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	DPÇSHJ	Në vijimësi	139		139		139		Numri i raportimeve të kryera nga ILD për institucionet e huaja dhe vendase
Koordinimi brenda strukturave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas afateve të përcaktuara për raportim	DPÇSHJ në bashkëpunim me të gjitha strukturat e tjera të ILD	Në vijimësi	191		191		191		Numri i raportimeve
Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve vendase dhe ndërkombëtare sipas raporteve përkatëse	DPÇSHJ	Në vijimësi	14		14		14		Rekomandimet e zbatuara

Objektivi Specifik 3.2: Ndjekja/Realizimi i aktiviteteve që Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë ka parashikuar për Zyrën e Inspektorit të Lartë të

<i>Drejtësisë</i>									
Identifikimi i burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve	DESHM dhe asistencë e huaj + MD	Në vijimësi	207		347		347		Mënyra e financimit
Zbatimi i aktiviteteve sipas afateve kohore të përcaktuara	DPÇSHJ	Në vijimësi							Numri i aktiviteteve
Objektivi Strategjik 4: Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të lartë të Drejtësisë.									
<i>Objektivi Specifik 4.1: Rritja e aksesit të publikut përmes komunikimit dhe bashkëpunimit me qytetarët.</i>									
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Struktura Përgjegjëse	Afati	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2020		Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2021		Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2022		Treguesi cilësor/sasior
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	
Hartimi dhe publikimi i modelit të formularit të ankesës dhe udhëzuesit	DPÇSHJ	Shtator 2020	199						Përcaktimi i qartë i elementëve që duhet të përmbajë Formulari i Ankesës
Ofrimi i faciliteteve infrastrukturore për të ngritur një njësi për pritje të publikut	DPÇSHJ	Mars 2021							Anketë vlerësimi
Ofrimi i asistencës së nevojshme lidhur me takimet e mundshme dhe ofrimin e këshillimit për plotësimin e formularit	DPÇSHJ	Në vijimësi	546		546		546		Anketë vlerësimi
Ofrimi i informacioneve (raporte, statistika të gjeneruara nga sistemi) të thjeshtuara									Numri i raporteve të publikuara në faqe.

në faqen web për								
Publikimi i rezultateve të inspektimit dhe vendimeve të marra në përputhje me parashikimet e ligjit, në një gjuhë të thjeshtuar për publikun								
Ofrimi i trajnimeve për personat përgjegjës për pritjen me publikun	DPÇSHJ dhe sektori i Buimeve Njerëzore	Dhjetor 2020	11					Numri i trajnimeve dhe personave që do të trajnohen
<i>Objektivi Specifik 4.2: Zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit me qëllim bashkëpunimin me publikun si dhe transparencën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</i>								
Rikonceptim i “design” të faqes zyrtare për lehtësimin dhe aksesueshmërinë e marrjen e informacionit.	Sektori i TI	Dhjetor 2020	120					Numri i personave që vizitojnë faqen zyrtare të ILD
Publikimi i informacionit për funksionimin e ILD në kuadër të transparencës	Sektori i TI dhe DPÇSHJ	Në vijimësi	1,183		1,133		1,133	Nr.dokumenteve të publikuara
Krijimi i kushteve (zhvillimi i portalit në faqen e Web-it të ILD-së) për	TI dhe DPÇSHJ	Shtator 2020	1,133		1,133		1,133	Nr.i ankesave online

plotësimin e ankesave në formë elektronike (on-line) dhe ngarkimi i dokumentacionit shoqërues Zhvillimi i njoftimeve publike në portal								
<i>Objektivi Specifik 4.3: Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat esinjalizimittëveprimeve ose praktikave të dyshuara të korrupsionit</i>								
Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për sinjalizimin e veprimeve ose praktikave korruptive të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	Sekretari i Përgjithshëm	Tetor 2021						Fushata ndërgjegjësimi

Aneks

Vlerësimi i riskut

Matrica më poshtë paraqet vlerësimin e riskut në zbatimin e strategjisë në rast të mos arritjes së objektivave, duke përfshirë një vlerësim të probabilitetit të ndodhjes së riskut, ndikimin e mundshëm të rrezikut si dhe propozimin për veprime lehtësuese për të shmangur ndodhjen e rrezikut ose për ta zbutur atë nëse / kur ndodh.

Përshkrimi i riskut	Niveli i vlerëimit të riskut	Ndikimi i Mundshëm	Veprimet lehtësuese
Legjenda e vlerëimit të riskut	Pa ngjyrë Risk i ulet	Risk i mesëm	Risk i lartë
I. Politikat e Riskut			
a) Perceptimi negativ i publikut në sistemin e drejtësisë	I Lartë	I Mesëm	<ul style="list-style-type: none">• Rritja e aksesit të publikut përmes komunikimit dhe bashkëpunimit me qytetarët.• Zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit me qëllim bashkëpunimin me publikun si dhe transparencën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.• Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat e sinjalizimit të veprimeve ose praktikave të dyshuara të korrupsionit
II. Risku i bashkëpunimit ndërinstitucional			
b) Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional	I Mesëm/I Lartë	I Mesëm	<ul style="list-style-type: none">• Realizimi i aktiviteteve që Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë ka parashikuar

			<p>për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> Hartimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me institucionet e Sistemit të Drejtësisë dhe Institucionet e tjera me rol në procesin e verifikimit
c) Mungesa e ngritjes së QTI në sistemin e Drejtësisë	I Lartë	I Mesëm	Ngritja e sistemit të menaxhimit të çështjeve në ILD
III. Risku Institucional			
d) Numri i reduktuar i magistratëve në sistem.	I Lartë	I Lartë	<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunimi me KLGJ dhe sistemin gjyqësor për të shpejtuar procesin Nëse nuk mjafton, promovimi i nismave ligjore për të siguruar përshpejtimin e procesit
e) Zvarritja e shqyrtimit të procedimeve.	I Lartë	I Lartë	<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të TI të lidhura me platformën e drejtësisë Zhvillimi i kapaciteteve për të punuar me sistemet e menaxhimit të performancës
f) Paqartësi në zbatimin e procedurave ligjore.	I Mesëm	I Lartë	<ul style="list-style-type: none"> Nxjerrja e akteve nënligjore për garantimin e të kuptuarit dhe zbatimit uniform të ligjit. Përjasja e metodave/proceseve të punës me standardet ndërkombëtare për hetimin disiplinor dhe inspektimin. Zhvillimi i sistemit të ri të raportimit statistikor.
IV. Risku nga mungesa e burimeve financiare dhe burimeve njerëzore			

a) Mungesa e burimeve financiare nga Ministria e Financave dhe donatorët	I Mesëm	I Mesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi i nevojave për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të Programit Afatmesëm Buxhetor dhe buxhetit vjetor. • Në situatën e mungesës së burimeve financiare, Identifikimi me komunitetin e donatorëve mundësitë për mbështetje financiare të nevojshme për ato masa, të cilat aktualisht nuk janë të mbuluara financiarisht.
b) Mungesa e burimeve të personelit të kualifikuar	I Mesëm	I Mesëm/i Lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Programe trajnimi për të gjithë stafin për metodat dhe qasjet evropiane në punën e ILD
c) Mungesa e burimeve financiare për hapësira për zyra.	I Mesëm	I Mesëm/i Lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi i nevojave për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të Programit Afatmesëm Buxhetor dhe buxhetit vjetor. Në situatën e mungesës së burimeve financiare, Identifikimi me komunitetin e donatorëve mundësitë për mbështetje financiare të nevojshme për ato masa, të cilat aktualisht nuk janë të mbuluara financiarisht.

Vlerësimi i riskut do të ë rishikohet dhe azhurnohet çdo vit si pjesë e punës në një raport vjetor si dhe do të rishikohen masat kur është e nevojshme.